



4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1124/Prot

Elbasan më 26 /02/ 2020

VENDIM

Nr. 20 datë 26 /02/2020

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin JANAR 2020 gjithsej 95 familje me një fond prej 283.324 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Vendimi nr 2 datë 27.01.2020 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2020” shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja







84

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1213 Prot

Elbasan më 02/03/2020

VENDIM

Nr. 22 datë 26/02/2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN”**

Këshilli Bashkiak Elbasan në mbledhjen e tij të datës 21.02.2019 në mbështetje Ligjit nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetë qeverisjes Vendore”

VENDOSI:

1. Të miratoj Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Elbasan, sipas tekstit bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Bashkiak, Sekretari Këshillit Bashkiak, Kryetari dhe Administrata e Bashkisë më njohjen, respektimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd GRIPSHI

KRYETARI
Hektor ÇIFTJA





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1003/Prot.
11

Datë 02.02. 2020

VENDIM

NR. 23 DATË 26 . 02. 2020

MBI

“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2019”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 26.02.2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2019”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Të miratoje “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë të vitit 2019” (janar-dhjetor 2019), për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETARI
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja





Handwritten text in a curved arrangement, possibly a signature or a date. The text is written in a non-Latin script, likely Arabic or Persian, and is oriented vertically.

Handwritten text in a vertical arrangement, possibly a signature or a date. The text is written in a non-Latin script, likely Arabic or Persian, and is oriented vertically.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1001 Prot.
11

Datë 02 .02. 2020

VENDIM

NR. 24, DATË 26. 02. 2020
MBI

**“VLERSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PER VITET
2021-2023**

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan, i mbledhur sot më datë 26. 02. 2020, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura administrata e Bashkia Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2021-2023”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Elbasan për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme 2021-2023, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajdi GRIPSHI

KRYETARI
Hektor Çiftja





Handwritten signature and date:
 [Signature]
 10/10/10

Handwritten text:
 [Signature]

VLERESIMET DHE RASHIKIMET AFATMESME TE TE ARDHURAVE TE BASHKISE ELBASAN PER PERIUDHEN 2018-2023

ne mije leke

EMERTIMI	Fakt 2018	Fakt 2019	Plan 2020	PARASHIKIMI 2021	PARASHIKIM I 2022	PARASHIKIMI 2023
A Te ardhura nga taksat	235,907	302,233	603,035	621,126	633,549	646,220
1 Taksa vendore mbi veprimtarine ekonom.te biznesit te vogel	215	50	50	52	53	54
2 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e BV	7,869	8,356	8,575	8,832	9,009	9,189
3 Taksa mbi ndertesat	135,516	154,373	217,270	223,788	228,264	232,829
4 Taksa mbi token bujqesore	22,114	17,900	26,990	27,800	28,356	28,923
5 Taksa mbi truallin	28,071	22,720	26,300	27,089	27,631	28,183
6 Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	10,891	9,157	9,200	9,476	9,666	9,859
7 Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	30,483	88,953	313,900	323,317	329,783	336,379
8 Taksa e tabelas	748	724	750	773	788	804
B Te ardhura nga taksat e ndara	62,487	69,035	76,000	86,290	88,016	89,776
1 Taksa e kalimit te se drejtes se pronesise per pasurite e palujtshme	9,681	5,891	6,000	8,400	8,568	8,739
2 Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura	52,708	60,039	60,000	61,800	63,036	64,297
3 Renta minerare	98	3,105	3,000	3,090	3,152	3,215
4 Tatimi mbi te ardhurat personale	0	0	7,000	13,000	13,260	13,525
Te ardhura nga tarifat	295,060	295,950	414,885	435,672	444,385	453,273
1 Tarife zenie hapese publike (tavolina + zenie hapesire)	30,568	31,751	49,060	58,872	60,049	61,250
2 Tarife pastrimi	139,661	142,363	159,220	163,997	167,277	170,622
3 Tarife gjelberimi	30,491	27,722	39,300	40,479	41,289	42,114
4 Tarife ndricimi	37,557	35,614	69,280	71,358	72,786	74,241
5 Tarife miremb.infrastukture ne Nj.Administrative			4,640	4,779	4,875	4,972
6 Tarife reklame	12,532	6,282	6,500	6,695	6,829	6,965
7 Tarife veterinare	3,414	1,277	1,500	1,545	1,576	1,607
8 Tarife parkimi	6,999	6,890	29,450	30,334	30,940	31,559
9 Tarife embleme	100	114	100	103	105	107
10 Tarife regjistrimi	36	3	5	5	5	5
11 Tarife leje certifikate transporti	2,037	1,899	2,000	2,060	2,101	2,143
12 Tarife per autorizim karburanti + lende djegese	3,000	6,120	5,000	5,150	5,253	5,358
13 Tarife per vertetime	2,255	2,324	2,350	2,421	2,469	2,518
14 Tarife dokumenta ankandi	0	2	5	5	5	5
15 Tarife zgjatje orari	578	265	1,100	1,133	1,156	1,179
16 Tarife formulare te pastrehe	31	19	25	26	26	27
17 Tarife karrotrec	69	51	480	494	504	514
18 Tarife leje perdorimi per objekte biznesi	1,451	701	1,000	1,030	1,051	1,072
19 Tarife leje perdorimi per objekte banimi	1,084	805	1,000	1,030	1,051	1,072
20 Tarife certifikim relievi	608	672	700	721	735	750
21 Tarife deklarim paraprak	765	1,130	1,700	1,751	1,786	1,822
22 Tarife fasade	1,311	1,278	1,600	1,648	1,681	1,715
23 Tarife aplikim leje zhvillimi			300	309	315	321
24 Tarife hartim PDV per siperfaqen e prones			300	309	315	321
25 Tarife plan rievimi			200	206	210	214
26 Tarife shqyrtim dok.leje ndertimi	1,717	2,140	2,600	2,678	2,732	2,786
27 Tarife kantier ndertimi objekt mbi 4 kat	2,450	6,005	7,000	7,210	7,354	7,501
28 Tarife dokumenta nga arkiva	131	165	200	206	210	214
29 Tarife rrethi tubacioneve te ujrave te bardha	0	4,395	2,200	2,266	2,311	2,358
30 Tarife rrethi tubacioneve te ujrave te zeza	0	566	290	299	305	311
31 Tarife sherbimi per rrethin kabllor	994	996	4,000	4,120	4,202	4,286
32 Tarife uji i pijshem	199	58	100	103	105	107
33 Tarife ndotje mjedisi	15,022	14,343	21,680	22,330	22,777	23,233
Te ardhura te tjera	40,322	56,782	168,089	126,782	129,317	131,904
1 qera pajisje	39	0	0	0	0	0
2 qera objekti	1,348	1,594	1,484	1,529	1,559	1,590
3 qera trualli (operatore telefonike)	2,455	896	2,143	2,207	2,251	2,296
4 qera toke bujqesore	312	317	500	515	525	536
5 qera toke pyjore	543	5,345	9,162	9,437	9,626	9,818
6 gjoba ndertimi	1,124	987	2,000	2,060	2,101	2,143
7 gjoba biznesi	9,363	5,041	9,800	10,094	10,296	10,502
8 te ardhura nga legalizimet	25,138	42,394	98,000	100,940	102,959	105,018
9 Te ardhura nga shitja e aksioneve (FK Elbasani)	0	0	45,000	0	0	0
10 Privatizim banese	0	208	0	0	0	0
Te ardhura nga institucionet vartese	46,941	50,048	69,643	71,732	73,167	74,630
1 Kopeshte (QEA)	21,255	20,673	34,848	35,893	36,611	37,344



9

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1002/11 Prot.

Datë 02.02. 2020

VENDIM

NR. 25, DATË 26. 02. 2020

MBI

“TAVANET PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2021-2023”

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë 26. 02. 2020, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2021-2023, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajdi GRIPSHI

KRYETARI
Hektor Ciftja





UNIVERSITY OF THE PHILIPPINES
MANILA

1978

11

2	Çerdhe (QEA)	4,910	5,896	10,454	10,768	10,983	11,203
3	Qera objekti (QEA)	6,227	9,033	8,975	9,244	9,429	9,618
4	Klubi Shumesporte	1,051	841	816	840	857	874
5	Qendra e Artil	662	1,404	850	876	893	911
6	Trashegimia Kulturore	63	75	100	103	105	107
7	Sherbimet Publike	5,711	4,703	6,100	6,283	6,409	6,537
8	Menaxhimi Banesave Sociale	7,062	7,423	7,500	7,725	7,880	8,037
	Te ardhura nga funksionet specifike	8,418	11,579	12,340	12,710	12,964	13,224
1	Tarifa sherbimi te MZSH	0	0	0	0	0	0
2	Tarifa te sherbimit pyjor	6,995	8,349	8,780	9,043	9,224	9,409
3	Tarifa nga ujitja dhe kullimi	1,423	3,230	3,560	3,667	3,740	3,815
	Totali I :	689,135	785,627	1,343,992	1,354,312	1,381,398	1,409,027
	Te ardhura nga huaja	3,802	1,476	90,374	0	0	
	Transferta e pakushtezuar	636,618	673,776	695,697	757,887	805,374	829,535
	Transferta specifike	398,045	418,118	418,637	418,637	418,637	418,637
	Te ardhura te trasheguara	280,877	274,048	137,265			
	Totali II	2,008,477	2,153,045	2,685,965	2,530,836	2,605,409	2,657,199
	Te ardhura jasht limiti	2,763	15,962	5,800	5,860	5,925	6,044
1	Takse pulle (agjent tatimor)	663	596	700	700	704	718
2	Sponsorizim		3,906	3,000	3,060	3,121	3,184
3	Transferta K.Qarkut	2,100	7,430	2,100	2,100	2,100	2,142
4	Demshperblim kompani sigurimesh		4,030				
	Gjithsej te ardhurat :	2,011,240	2,169,007	2,691,765	2,536,696	2,611,334	2,663,243





5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 973/11 Prot.

Datë 02.02. 2020

VENDIM

NR. 26 DATË 26 . 02. 2020

MBI

“Rishpërndarje fonde, në buxhetin e vitit 2020”,

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 26. 02. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Rishpërndarje fonde, në buxhetin e vitit 2020”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimin nr.2, datë 20.01.2020 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.201, datë 24.12.2019 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020”,

VENDOSI :

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2020, duke bërë transferimet nga Ndërmarrja Mirëmbajtje Terrene Sportive në Klubin Shumësportesh Elbasan dhe Agjensinë e Shërbimeve Publike, si më poshtë :

Paksohet :

Prog	Kap.	Art.	Shuma/lekë	Njësia Shpenzuese
08130	1	600	12,000,000	Mirëmb. Terrene Sportive
08130	1	601	2,000,000	“ “
08130	1	602	720,000	“ “
08130	5	600	3,300,000	“ “
08130	5	601	470,000	“ “
08130	5	602	605,000	“ “
			Gjithsej : 19,095,000	

Shtohet :

Prog	Kap.	Art.	Shuma/lekë	Njësia Shpenzuese
08130	1	600	8,060,000	Klubi Shumësportesh
08130	1	601	1,360,000	“ “



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1000/11 Prot.

Elbasan më 02.08.2020

V E N D I M

Nr. 27 Datë: 26.02.2020

“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e Z. Qemal Hasan Sherja , banor i fshatit Korrë, Njësia Administrative Funar si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __.02.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Qemal Hasan Sherja** , banor i fshatit Korrë, Njësia Administrative Funar si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e tokës në banesën e shtetasit **Z. Qemal Hasan Sherja** , e cila është në **489 487** (katër qind e tetëmbëdhjetë e nëntë mijë e katër qind e tetëdhjetë e shtatë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë, d.m.th. **978 955 x 50% = 489 487** lekë.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **489 487** (katër qind e tetëmbëdhjetë e nëntë mijë e katër qind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, për familjen e **Z. Qemal Hasan Sherja** .
4. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 252 datë 24.12.2019.

5

5. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Klajdi Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja



Handwritten signature or initials in the center of the page.



Handwritten text or numbers in the lower-right quadrant, possibly a date or reference number.



36

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10311 Prot.

Elbasan më 02.02.2020

V E N D I M

Nr. 28 datë 26.02.2020

P Ë R

DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK
PËR NDËRTIMIN E HC-it "BUKANIKU" NË PËRROIN E QERSHISË

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 26.02.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligjin nr. 9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullor", i ndryshuar,
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433 dt.8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive",
- Vendimin e Këshillit Ministrave nr.1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvoglimit të sipërfaqes edhe të vëllimit të fondit pyjor" i ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik";

V e n d o s i:

- Të miratojë dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor e kullor publik sipas listës bashkëlidhur dhe planvendosjes të sipërfaqeve mbi të cilat do të shtrihet tubacioni i transmetimit të ujit për hidrocentralin "Bukaniku" në përroin e Qershisë dhe linjës së tensionit elektrik për transmetimin e energjisë 35 kV, për të cilët, procedura e dhënies së lejes ka nisur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Afati i dhënies në përdorim sipas pikës 1 të këtij vendimi do të jetë 9 vjet, ndërsa tarifat e përcaktuara në VKM nr. 391, datë 21.6.2006, (i ndryshuar), përbëjnë vlerën e qirasë vjetore.

3. Kjo kontratë do t'i fillojë efektet e saj pas miratimit përfundimtar të ndërtimit të objektit (burim gjenerues energjie) nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (sektori i pronave) dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Ciftja



12-11-1964



12/11/64

12/11/64



10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 1028/11 Prot.

Elbasan, më 02.03.2020

Vendim

Nr. 29 Datë 26/02/2020
Për miratimin e kontratës së grantit

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 26/02/2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë për kontratën e grantit dhënë nga ambasada e Japonisë në Tiranë, në kuadër të projektit “Për përmirësimin e parqeve dhe zonave të gjelberta në Bashkinë Elbasan” për blerjen e mjeteve si ekskavatorë dhe makinë prerëse bari, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nënet 8,9,54 të tij,

Vendosi

- 1- Të miratojë kontratën e grantit prej 74606 (shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtë) euro. ndërmjet Ambasadës së Japonisë dhe Bashkisë Elbasan, për Agjensinë e Shërbimeve Publike, sipas tekstit bashkangjitur këtij vendimi.
- 2- Ngarkohen Kryetari dhe administrata e Bashkisë dhe Agjencia e Shërbimeve Publike, me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Sek. K. Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari
Hektor Ciftja





21

1911

Very faint, illegible text in the middle of the page.



111



9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1030/11 Prot.

Elbasan, më 27.02.2020

VENDIM

Nr. 30 datë 26.02.2020

“Për krijimin e Muzeut të Arsimit”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____02.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore “Për krijimin e Muzeut të Arsimit”, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), në ligjin nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

VENDOSI:

1. Të miratojë, në parim, krijimin e Muzeut të Arsimit pranë Qendrës së Trashëgimisë Kulturore, si institucion në varësi të Bashkisë Elbasan.
2. Detyra kryesore funksionale e këtij institucioni do të jetë sigurimi i ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të dokumentave arsimore, që konsiderohen trashëgimi kulturore, si dhe të krijojë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.
3. Veprimtaria dhe organizimi administrativ i këtij institucioni do të bëhet në përputhje me procedurën ligjore të përcaktuar në ligjin nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Qendra e Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve në Bashki.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi


KRYETARI

Hektor Çiftja





WFO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1026/1 Prot.

Elbasan, më 02.02.2020

VENDIM

Nr. 31 datë 26.02.2020

"Mbi të drejtën e shpërndarjes së botimit "Elbasani në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit" nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __.02.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore "Mbi të drejtën e shpërndarjes së botimit "Elbasani në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit" nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore", bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar) dhe në Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar),;

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërndarjen e botimit "Elbasani në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit", për personalitete dhe ambasadorë të huaj, agjenci turistike vendase dhe të huaja, Bibliotekës së qytetit, shoqatave kulturore etj., sipas planit të shpërndarjes bashëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra e Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve në Bashki, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja



**TABELA E SHPËRNDARJES SË KOPJEVE TË BOTIMIT "ELBASANI NË
DOKUMENTAT OSMANE TË ARKIVIT TË STAMBOLLIT"**

Sasia e kopjeve të librit të botuar	300
Sasia e kopjeve të librit, që do t'i shpërndahen Bibliotekës së qytetit të Elbasanit "Q. Baholli"	5
Sasia e kopjeve të librit, që do t'i shpërndahen Bibliotekës Kombëtare	5
Sasia e kopjeve të librit, parashikuar për t'iu shpërndarë personaliteteve, agjencive turistike vendase dhe të huaja, shoqatave kulturore, bibliotekave të shkollave etj.	290